



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety	09-06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
Sikmshkic	4662/2023		119	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.696/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga; Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti- anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj –Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.696/2023 të datës 02.05.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2023, morri këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.696/2023 e datës 02.05.2023 e parashtruar nga ankuesi**

### A r s y e t i m

Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, neni 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 6 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, më datë 02.06.2022 ka shpallur konkursin e brendshëm me numër Nr.622 dhe numër të referencës MD/SHKK/010/01.06.2022 për dy (2) pozita të lira “Mbikëqyrës i Lartë” në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Ankuesi i punësuar sipas Kontratës së punës me numër KI 1011918898 të datës 25.06.2018 në pozitën e punës “Oficer Korrektues” në Shërbimin Korrektues të Kosovës/Qendra e Paraburgimit në Gjilan. Më datë 14.07.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ankuesi ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në njoftimin e datës 01.09.2022 i njëjti është njoftuar me pikët e arritura gjithsejtë gjashtëdhjetë e tetë pikë tetë (68.8) pikë, duke u renditur i treti (3) në listën përfundimtare.



Ankuesi i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të datës 01.09.2022 për pozitën "Mbikëqyrës i lartë" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ka parashtruar kërkesë për përzgjedhje dhe emërim me numër të protokollit Nr.0376/23 më datë 20.03.2023 për Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues dhe Njësinë e Burimeve Njerëzore/Drejtoria Qendrore e SHKK-së me të cilën kërkon që të bëhet përzgjedhja e tij për emërimin e tij në pozitën "Mbikëqyrës i Lartë" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan. Ndërsa me datë 25.04.2023 ka pranuar përgjigje në kërkesë me numër të protokollit Nr.512 me të cilin i është refuzuar si e pa bazuar kërkesa me numër të Nr.0376/23 e datës 20.03.2023.

Ankuesi i pakënaqur me refuzimin e kërkesës me numër Nr.0376/23 të datës 20.03.2023 për përzgjedhje dhe emërim nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm, më datë 02.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3984/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër konkursit të brendshëm me numër të protokollit Nr.622 të datës 02.06.2023. Me pretendimin ankimor për shkak të moszbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, shkëlqje të parimeve të përgjithshme të Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik e në veçanti "parimit të pranimit të Zyrtarëve Publik" si dhe parregullsive në zbatimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhje dhe emërim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimin korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli me datën 01.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova:** Ankesë me numër të protokollit 3984/2023 e datës 02.05.2023; Kërkesë me numër të protokollit Nr.0376/23 e datës 20.03.2023; Përgjigje në kërkesë me numër të protokollit Nr.512 e datës 25.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 01.06.2023; Konkurs i brendshëm me numër të protokollit Nr.749 i datës 30.05.2023; Vendim me numër të protokollit Nr.432 i datës 05.04.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar me numër reference KI, 1011918898 e datës 25.06.2018; Konkurs i brendshëm me numër Nr.622 dhe numër të referencës MD/SHKK/010/01.06.2022 i datës 02.06.2022; Vendim me numër të protokollit 774 i datës 12.07.2022; renditje përfundimtare e kandidatëve e datës 01.09.2022; Rezultatet e vlerësimit të intervistës me gojë më datë 31.08.2022; Lista e ftesës për intervistë me gojë; Njoftim i datës 23.08.2022; Rezultatet e vlerësimit të testit me shkrim më datë 19.08.2022; Lista e kandidatëve që nuk e kanë kaluar testin me shkrim me datë 19.08.2022; Lista e zyrtarëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për të ju nënshtruar testit me shkrim; Testi me shkrim i datës 18.08.2022; Kërkesa për punësim e datës 14.07.2022; Diplomë e datës 10.10.2019; Diplomë e datës 11.06.1998; Certifikatë e datës 08.07.2022; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 16.12.2020; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 18.02.2022; Letërnjoftim i Vërtetim i datës 14.07.2022; Dëshmi e datës 02.05.2005-06.05.2005; Certifikatë e datës 22.03-26.03.2010; Certifikatë e datës 25.09.2008; Certifikatë e datës 30.04-08.05.2014; Certifikatë 21.12-23.12.2009; Certifikatë e datës 24.11.2000.





Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se për konkursin e brendshëm me numër Nr.622 dhe numër të referencës MD/SHKK/010/01.06.2022 për pozitën, "Mbikëqyrës i Lartë" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, kanë aplikuar tetëdhjetë e tri (83) kandidatë, testin me shkrim e kanë kaluar tridhjetë e dy (32), ndërsa intervistën me gojë e kanë kaluar njëzet e tre kandidat (23) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit të testit me shkrim dhe vlerësimit të intervistës me gojë, ankuesi nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme në total prej gjashtëdhjetë e tetë pikë tetë (68.8) pikë dhe i njëjti është radhitur i treti (3) në listë, ndërsa në konkurs janë shpallur vetëm dy pozita të lira.

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese ju referua edhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, dhe 2 si dhe nën paragrafët nga 2.1 deri në 2.5 ,ku shprehimisht është e definuar "1.Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1 kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2 të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3 rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4 zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5 transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve". Si dhe Udhëzimin Administrativ MD-NR. 02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi përkatësisht nenit 15, 16 dhe 17 ku përcaktohet se 15." Kandidatët të cilët sipas konkursit të shpallur për avancim, për gradën II, III dhe IV i plotësojnë kriteret e përcaktuara do t'u nënshtrohen procedurave të testimit. 2. Procedura e testimit mbahet sipas radhitjes vijuese: 2.1. testi me shkrim; 2.2. intervista me gojë. 3. Kandidati që dështon në njërin nga fazat e përzgjedhjes nuk ka të drejtë të vazhdojë në fazat tjera të procesit të rekrutimit".16" Testi me shkrim përpilohet në dy gjuhët zyrtare dhe mund t'i përmbaj deri 50 pyetje. Çdo përgjigje e saktë mund të vlerësohet deri 2 poena. Testi hartohet për të testuar njohurit në fushën e legjislacionit penal, ekzekutivin e sanksioneve penale aktet normative dhe administrative që normojnë veprimtarinë e institucioneve korrektuese, dhe shkathtësitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit 2.Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin me shkrim është 60 poena". 17." 1. Në intervistë kandidatëve do t'u bëhen një sërë pyetjesh të standardizuara duke përfshirë aftësitë komunikuese, udhëheqjes, vendimmarrjes, njohurit dhe përvojat profesionale, por duke mos u kufizuar me kaq. 2. Kandidati duhet të arrijë së paku rezultatin 60%". " Kandidati i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka arritur të grumbulloj më së shumti poena por jo më pak se 60 % të maksimumit të pikëve të caktuara".

Nga provat e lëndës, rrjedhë se ankuesi kundër këtij procesi nuk ka parashtruar ndonjë ankesë, mirëpo i njëjti kërkon që të emërohet në pozitën përkatëse pa procedurë, ngase nëse konkursi ka qenë për dy pozita të lira atëherë emërimi nga konkursi paraprak është bërë në këto pozita dhe nuk ka bazë ligjore që ankuesi të emërohet në pozitën përkatëse pa procedurë, sepse sipas Udhëzimit Administrativ, MD-NR. 02/2022 për Gradat e



Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, nuk parashihet të ketë listë të pritjes së kandidatëve të cilët kanë kaluar në procedurat e rekrutimit.

Nga provat e lëndës shihet që Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 30.05.2023 ka shpallur konkurs të brendshëm për pozitën *Mbikëqyrës i Lartë* për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan një pozitë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se emërimi në mënyrë të përhershme në një pozitë përkatëse bëhet në pajtim me procedurat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Udhëzimit Administrativ MD-NR. 02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A .nr. 696/2023**

**Kaltrina Avdullahi Prenaj**



Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

